

Z. Ryisim Xhaja ka përfunduar studimet e larta pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në periudhën 1997-2001. Gjithashtu ka kryer studimet pasuniversitare, "Master Shkencor", pranë Departamentit të Drejtës Civile me temë; "*Probleme të Bazave Teorike dhe Juridike të Pronësisë Intelektuale*", në vitin 2009.

Z. Xhaja ka eksperiençë të gjatë në sektorin publik dhe atë privat, që prej vitit 2000 ku ka punuar si Konsulent juridik dhe pas diplomimit si jurist, për "Kreiss Basel" Sh.p.k. deri në vitin 2001. Më pas në periudhën 2003-2004, ka punuar si Jurist në Regjistrimin Fillestar Sistematik të Pasurive të Paluajtshme pranë ZVRPP Tiranë, për "Ina Company". Gjatë periudhës 2004-2005, ka mbajtur pozicionin, Jurist dhe Përgjegjës i Sektorit Juridik në Institutin e Monumenteve të Kulturës. Më tej në periudhën 2005-2006, Kontrollor/ Jurist në Komitetin Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Drejtoria e Apelimit dhe Kontrollit.

Z. Xhaja ka filluar punë pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit që nga tetori 2006 e në vazhdim. Ka mbajtur pozicione pune si, Jurist Departamenti, Auditues, Jurist i Drejtorisë Juridike, Auditues i Lartë dhe Kryeauditues. Gjithashtu, z. Xhaja ka mbajtur edhe pozicionin e "Drejtorit" të Departamentit të Auditimit apo "Këshilltar" pranë Kabinetit të Kryetarit. Aktualisht është i emëruar në pozicionin e "Drejtorit" të Departamentit të Auditimit të Shoqërisë Publike dhe Investimeve të Huaja.

Z. Xhaja gëzon titullin Avokat, nga Dhoma Kombëtarë e Avokatisë që prej vitit 2003. Gjithashtu ka ushtruar mësimdhënie si Pedagog i jashtëm në vitet 2006-2008, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti jopublik "Kristal", lënda: Shkrim dhe Arsyetim Ligjor, dhe 2004-2007, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, lënda: Marrëdhënie Ndërkombëtare.

Gjatë kësaj eksperience të gjatë profesionale, Z. Xhaja ka kryer një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë vendit në lidhje me çështjet e auditimit të jashtëm në sektorin publik, Pjesëmarrës në workshop-in e zhvilluar nga Crown Agents Foundation për "New EU Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA) 2007-2013, Veles Magedoni. Pjesëmarrës nw "Training Programme on Supreme Audit" organizuar nga Turkish Court of Accounts (TCA) & Turkish International Cooperation and Development Agency (TIKA), Ankara Turqi Maj 2009. Pjesëmarrës në disa seminare trajnuese të zhvilluara nga KLSH për: Auditimin Financiar; Auditimin e Performancës; Trajnim për Trajnerët; Programin Idea, 2007-2010. Pjesëmarrës në disa seminare trajnuese të zhvilluar nga ITAP për: Prokurimin Publik, Kontrollin e Brendshëm dhe Antikorrupsionin, 2007-2010. Pjesëmarrës në kursin e plotë trajnues organizuar nga fondacioni "Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve" duke u aftësuar në rolin e drejtuesit për menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve. Pjesëmarrës në seminarin Integration of Youth in the Stability Pact në Ohër, Maqedoni. Pjesëmarrës në seminarin trajnues për Regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme, organizuar nga "Instituti i Regjistrimit te Pasurive", viti 2000. Në Nëntor të 2009 si Referues në seminarin trajnues të organizuar në KLSH me kontrollorët e departamentit me temë: Urbanistika.

Vlen për tu përmendur puna me kohë të pjesshme gjatë krizës Kosovare të vitit 1999, për Fondacionin Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve.

Z. Xhaja zotëron dhe ka njojuri shumë të mira në gjuhën angleze dhe italiane.